



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2728/2 prot.

Datë 25.09.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gamma” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-06449-05-24-2024, me objekt: “LOTI III: “Blerje pajisje didaktike për biologji, arsimit bazë dhe i mesëm” me fond limit 50,609,996.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga BOE “Marketing & Distribution + Euomed” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

Ankimues:

BOE ALMedical + Didakalba” SHPK me NIPT K21511002I, + NIPT K22223005Q dhe adresë: Rruga Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
Adresa: “Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Gamma” me NIPT K31510153H dhe adresë:Njësia Administrative nr.8, Rruga Dervish Hekali, Ndertesa nr.8, Tiranë.

BOE “Marketing & Distribution + Euomed” SHPK me NUIS J72124001N +K71718012P dhe adresë autostrada Tirane - Durres, Km.10, Tiranë.

Në datën 23.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4591 si dhe nr. Protokoli 2728/2024 datë 24.09.2024 i operatorit ekonomik BOE “ALMedical + Didakalba” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-06449-05-24-2024, me objekt: “LOTI III: “Blerje pajisje didaktike për biologji, arsimit bazë dhe i mesëm” me fond limit 50,609,996.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gamma” SHPK dhe shtim të arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Marketing & Distribution + Euromed” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, .

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

- Lidhur me operatorin ekonomik “Gamma” SHPK, ankimesi pretendon se nuk përmbush kërkesat/kriteret si me poshte:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët teknikë për mallrat e kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit. Në rastin e përsëritjes së artikujve në lista mjafton 1 (një) katalog teknik për artikull. Gjuha e katalogut mund të jete shqip ose anglisht.

- Lidhur me operatorin ekonomik BOE “Marketing & Distribution + Euromed” SHPK, ankimesi pretendon se nuk plotëson kriteret e kualifikimit:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së përlogaritur të lotit apo grupeve të loteve në rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët teknikë për mallrat e kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit. Në rastin e përsëritjes së artikujve në lista mjafton 1 (një) katalog teknik për artikull. Gjuha e katalogut mund të jete shqip ose anglisht.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 25.09.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri